



Funded by
the European Union



SELDI.net
Southeast European Leadership for
Development and Integrity



RAPORT MONITORUES

ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

NË BASHKINË POGRADEÇ, SHKODËR DHE ELBASAN

TIRANË 2026

PËRMBAJTJA

1.1. Llogaridhënia	8
1.1.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	8
1.1.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	8
1.2. Transparenca proaktive.....	9
1.2.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	9
1.2.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	10
1.3. Qasja strategjike ndaj integritetit	11
1.3.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	11
1.3.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	12
1.4. Standardet etike dhe të sjelljes së mirë	12
1.4.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	12
1.4.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	13
1.5. Meritokracia e burimeve njerëzore.....	14
1.5.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	14
1.5.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	14
2.1. Llogaridhënia	19
2.1.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	19
2.1.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	19
2.2. Transparenca proaktive	20
2.2.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	20
2.2.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	20

2.3. Qasja strategjike ndaj integritetit	20
2.3.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	20
2.3.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	21
2.4. Standardet etike dhe të sjelljes së mirë	21
2.4.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	21
2.4.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	21
2.5. Meritokracia e burimeve njerëzore.....	22
2.5.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	22
2.5.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	22
3.1. Llogaridhënia	24
3.1.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	24
3.1.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	24
3.2. Transparenca proaktive	25
3.2.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	25
3.2.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	25
3.3. Qasja strategjike ndaj integritetit	25
3.3.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	25
3.3.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	26
3.4. Standardet etike dhe të sjelljes së mirë	26
3.4.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	26
3.4.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	26
3.5. Meritokracia e burimeve njerëzore.....	26
3.5.1 Kuadri ligjor dhe institucional.....	26
3.5.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë	27

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport është përgatitur nga Qendra për Zhvillim dhe Integrim European (CEDI) në kuadër të projektit *“Lufta kundër korrupsionit: Të rinjtë në veprim”* i cili paraqet rezultatet e monitorimit të zbatimit të Planeve të Integritetit në tre njësi të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, përkatësisht Bashkinë Pogradec, Bashkinë Elbasan dhe Bashkinë Shkodër. Raporti ka për qëllim vlerësimin e integritetit institucional në këto bashki përmes analizës së kuadrit institucional dhe ligjor si dhe zbatimit të tij në praktikë, në përputhje me Planin e Integritetit për secilën bashki.

Monitorimi është bazuar në analizën e Planeve të Integritetit të miratuara nga bashkitë përkatëse, dokumenteve strategjike dhe rregullatore të brendshme, si dhe informacionit të publikuar në faqet zyrtare të institucioneve në kuadër të transparencës proaktive dhe llogaridhënies publike. Vlerësimi është realizuar në pesë fusha kryesore të integritetit institucional, përkatësisht llogaridhënia, transparenca proaktive, qasja strategjike ndaj integritetit, standardet etike dhe të sjelljes së mirë, si dhe meritokracia në menaxhimin e burimeve njerëzore.

Rezultatet e monitorimit tregojnë se ndonëse janë ndërmarrë hapa në drejtim të forcimit të integritetit institucional dhe përmirësimit të mekanizmave të transparencës në nivel vendor, mbeten sfida që lidhen me publikimin e informacionit mbi zbatimin e masave të Planit të Integritetit, funksionimin e mekanizmave të sinjalizimit dhe zhvillimin e kapaciteteve të administratës në fushën e etikës dhe integritetit.

Gjetjet e raportit synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e praktikave institucionale dhe në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor si dhe në funksion të forcimit të besimit të publikut ndaj institucioneve të vetëqeverisjes vendore.

HYRJE

Integriteti institucional përbën një element kyç në funksionimin efektiv dhe të përgjegjshëm të institucioneve të qeverisjes vendore, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve publike dhe në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj administratës. Në këtë kuadër, njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të hartojnë dhe zbatojnë politika të brendshme që synojnë parandalimin e korrupsionit, menaxhimin e riskut të integritetit dhe forcimin e transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut.

BASHKIA ELBASAN



Në kuadër të forcimit të integritetit institucional dhe zbatimit të politikave kombëtare për parandalimin e korrupsionit në administratën publike, Bashkia Elbasan ka hartuar dhe miratuar Planin Vendor të Integritetit për periudhën 2025–2028. Ky dokument përbën një instrument strategjik që synon të adresojë risqet e integritetit në nivel institucional dhe të përmirësojë funksionimin e administratës vendore përmes rritjes së transparencës dhe llogaridhënies publike.

Sipas relacionit për miratimin e këtij plani, dokumenti përbën një kornizë shumëvjeçare që synon parandalimin e korrupsionit, rritjen e transparencës në veprimtarinë institucionale, forcimin e llogaridhënies dhe promovimin e kulturës së etikës në administratën vendore. Plani është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjik në fuqi, duke u mbështetur në VKM nr. 241/2018, Strategjinë Kombëtare Antikorrupsion 2024–2030, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në kuadrin për menaxhimin e riskut institucional dhe konfliktin e interesit.

1.1. Llogaridhënia

1.1.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Në kuadër të forcimit të integritetit institucional, Plan i Vendor i Integritetit i Bashkisë Elbasan (2025 - 2028) trajton llogaridhënien si një nga komponentët themelorë për parandalimin e korrupsionit dhe përmirësimin e funksionimit të administratës publike vendore. Në këtë drejtim, dokumenti strategjik parashikon konsolidimin e mekanizmave të menaxhimit të riskut të integritetit përmes krijimit dhe përditësimit periodik të regjistrit të riskut, si dhe realizimin e auditimeve tematike mbi funksionet administrative që konsiderohen me risk të lartë. Gjithashtu, plani synon përmirësimin e proceseve të monitorimit të performancës institucionale përmes përdorimit të treguesve të matshëm, si dhe rritjen e transparencës në ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet publikimit të kohëve standarde të ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Përmes këtyre masave, synohet ngritja e një sistemi të strukturuar të llogaridhënies institucionale që mundëson kontrollin e proceseve të brendshme administrative dhe adresimin në kohë të risqeve të integritetit të identifikuara në institucion. Në këtë mënyrë, kuadri strategjik i parashikuar në Planin e Integritetit përbën bazën për forcimin e kontrollit të brendshëm dhe rritjen e përgjegjshmërisë institucionale ndaj publikut.

1.1.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Nga monitorimi i faqes zyrtare të Bashkisë Elbasan rezulton se institucioni ka ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të

rritjes së transparencës financiare dhe përmirësimit të aksesit të publikut në informacion në lidhje me menaxhimin e burimeve publike. Në faqen zyrtare evidentohet publikimi i dokumenteve që lidhen me buxhetin vjetor të bashkisë, paketën fiskale dhe raportet mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit, si dhe vendimet e Këshillit Bashkiak. Publikimi i këtyre dokumenteve kontribuon në rritjen e llogaridhënies institucionale dhe mundëson aksesin e qytetarëve në informacion mbi përdorimin e fondeve publike dhe proceset vendimmarrëse në nivel vendor. Megjithatë, nga monitorimi i faqes zyrtare nuk evidentohet publikimi i disa elementëve të parashikuar në Planin e Integritetit, siç janë regjistri i riskut të integritetit, rezultatet e auditimeve tematike dhe indikatorët e performancës institucionale që lidhen me integritetin. Mungesa e publikimit të këtyre elementëve kufizon mundësinë për një vlerësim të plotë të progresit institucional në drejtim të zbatimit të masave të Planit të Integritetit dhe në forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe llogaridhënies publike.

1.2. Transparenca proaktive

1.2.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Transparenca proaktive përbën një nga shtyllat kryesore të integritetit institucional dhe lidhet drejtpërdrejt me garantimin e aksesit të publikut në informacion mbi veprimtarinë e administratës vendore. Në këtë kuadër, Planin Vendor të Integritetit të Bashkisë Elbasan (2025 – 2028) parashikon ndërmarrjen e një sërë masash që synojnë rritjen e transparencës institucio-

nale dhe përmirësimin e komunikimit me qytetarët. Dokumenti strategjik parashikon transformimin e faqes zyrtare të bashkisë në një platformë funksionale për publikimin e informacionit në kohë reale, duke përfshirë të dhëna mbi buxhetin e institucionit, vendimet e Këshillit Bashkiak dhe proceset e prokurimit publik. Gjithashtu, në Plan parashikohet publikimi i projekt-vendimeve për konsultim publik, si dhe rritja e aksesit të qytetarëve në informacion mbi kontratat publike në format të hapur. Në këtë mënyrë, kuadri strategjik i parashikuar në Planin e Integritetit synon të përmirësojë transparencën proaktive të institucionit dhe të garantojë përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel vendor.

1.2.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Nga monitorimi i faqes zyrtare të Bashkisë Elbasan rezulton se institucioni ka ndërmarrë masa për publikimin e informacionit institucional dhe financiar në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni për të drejtën e informimit. Në faqen zyrtare evidentohet publikimi i dokumenteve që lidhen me buxhetin e bashkisë, vendimet e organeve vendimmarrëse dhe njoftimet për konsultime publike. Megjithatë, nga monitorimi i faqes zyrtare evidentohet se publikimi i kontratave të prokurimit publik në format të hapur nuk realizohet në mënyrë të plotë dhe sistematike. Gjithashtu, nuk evidentohet publikimi i indikatorëve të performancës institucionale dhe të dhënave në kohë reale mbi ofrimin e shërbimeve publike, siç

parashikohet në Planin e Integritetit. Mungesa e publikimit të këtyre elementëve kufizon mundësinë për transparencë të plotë proaktive dhe përfshirjen efektive të qytetarëve në monitorimin e veprimtarisë së institucionit.

1.3. Qasja strategjike ndaj integritetit

1.3.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Qasja strategjike ndaj integritetit institucional në Bashkinë Elbasan është e reflektuar në Planin Vendor të Integritetit (2025 – 2028), i cili përbën dokumentin kryesor strategjik për menaxhimin e riskut të integritetit në institucion. Plani është hartuar mbi bazën e një procesi vlerësimi fillestar të riskut të integritetit në proceset administrative dhe operacionale të bashkisë dhe synon identifikimin dhe trajtimin e risqeve që mund të ndikojnë në ushtrimin e funksioneve të institucionit. Në këtë drejtim, Plani parashikon krijimin dhe përditësimin e regjistrit të riskut të integritetit, hartimin e planit të trajtimit të risqeve të identifikuara dhe monitorimin periodik të zbatimit të masave të planifikuara. Gjithashtu, dokumenti strategjik parashikon forcimin e mekanizmave të sinjalizimit të shkeljeve dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale për trajtimin e rasteve të raportuara. Përmes këtyre masave, synohet krijimi i një qasjeje të strukturuar dhe të qëndrueshme ndaj menaxhimit të integritetit institucional dhe përmirësimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm.

1.3.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Nga monitorimi i faqes zyrtare të Bashkisë Elbasan rezulton se institucioni ka publikuar informacion mbi mekanizmat e sinjalizimit dhe procedurat për paraqitjen e ankesave nga qytetarët. Këto mekanizma mundësojnë raportimin e shkeljeve të mundshme administrative dhe kontribuojnë në forcimin e integritetit institucional. Nisur nga monitorimi i faqes zyrtare nuk evidentohet publikimi i informacionit mbi regjistrin e riskut të integritetit apo raportet periodike mbi zbatimin e masave të Planit të Integritetit. Gjithashtu, nuk evidentohet publikimi i statistikave mbi trajtimin e rasteve të sinjalizuara apo rezultatet e monitorimit të risqeve të identifikuara. Mungesa e publikimit të këtyre elementëve kufizon mundësinë për një monitorim të plotë të zbatimit të Planit të Integritetit dhe vështirëson verifikimin e progresit institucional në drejtim të menaxhimit të riskut të integritetit.

1.4. Standardet etike dhe të sjelljes së mirë

1.4.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Standardet etike dhe sjellja e mirë në administratën publike përbëjnë një element thelbësor për garantimin e integritetit institucional dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike. Në këtë kuadër, Plani Vendor i Integritetit i Bashkisë Elbasan për periudhën 2025 - 2028 parashikon ndërmarrjen e një sërë masash që synojnë përforcimin e standardeve etike në administratë dhe parandalimin e situatave të konfliktit të interesit.

Dokumenti strategjik parashikon rishikimin dhe përditësimin e Kodit të Etikës për punonjësit e bashkisë, si dhe hartimin e procedurave të brendshme për deklarimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve administrative. Gjithashtu, në Plan parashikohet zhvillimi i trajnimeve periodike për stafin në lidhje me etikën në administratën publike dhe rregullat për pranimin dhe administrimin e dhuratave.

Nëpërmjet këtyre masave synohet rritja e ndërgjegjësimit të punonjësve mbi standardet e integritetit institucional dhe përmirësimi i praktikave të brendshme në drejtim të respektimit të parimeve të etikës publike.

1.4.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Nga monitorimi i faqes zyrtare të Bashkisë Elbasan rezulton se institucioni ka publikuar informacion mbi mekanizmat e sinjalizimit të shkeljeve dhe procedurat për paraqitjen e ankësave nga qytetarët. Megjithatë, nuk evidentohet publikimi i Kodit të Etikës të përditësuar për punonjësit e administratës, si dhe mungon informacioni mbi procedurat e brendshme për deklarimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit. Gjithashtu, nga monitorimi i faqes zyrtare nuk evidentohet publikimi i informacionit mbi zhvillimin e trajnimeve për stafin në fushën e etikës dhe integritetit institucional. Mungesa e publikimit të këtyre elementëve kufizon transparencën në lidhje me standardet etike të administratës dhe vështirëson verifikimin e zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Integritetit.

1.5. Meritokracia e burimeve njerëzore

1.5.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Menaxhimi i burimeve njerëzore në administratën publike përbën një nga komponentët kryesorë për forcimin e integritetit institucional dhe garantimin e funksionimit efektiv të institucioneve të vetëqeverisjes vendore. Në këtë kuadër, Plani Vendor i Integritetit i Bashkisë Elbasan për periudhën 2025–2028 parashikon ndërmarrjen e masave që synojnë përmirësimin e proceseve të rekrutimit dhe zhvillimit profesional të stafit në administratën e bashkisë. Dokumenti strategjik parashikon zhvillimin e trajnimeve të detyrueshme për punonjësit në lidhje me etikën dhe integritetin institucional, si dhe përdorimin e moduleve të trajnimit elektronik për rritjen e kapaciteteve të administratës në këtë drejtim. Gjithashtu, në Plan parashikohet integrimi i elementëve të integritetit në procesin e vlerësimit të performancës së stafit, me qëllim promovimin e meritokracisë dhe rritjen e përgjegjshmërisë në ushtrimin e detyrave administrative. Nëpërmjet këtyre masave synohet krijimi i një sistemi të menaxhimit të burimeve njerëzore që mbështetet në parimet e transparencës, meritokracisë dhe integritetit institucional.

1.5.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Nga monitorimi i faqes zyrtare të Bashkisë Elbasan rezulton se institucioni publikon njoftime për vende të lira pune në administratë, duke reflektuar një nivel transparence në proceset e rekrutimit të stafit.

Megjithatë, nuk evidentohet publikimi i informacionit mbi zhvillimin e trajnimeve për punonjësit në fushën e integritetit dhe etikës institucionale, si dhe mungon informacioni mbi përfshirjen e elementëve të integritetit në procesin e vlerësimit të performancës së stafit.

Mungesa e publikimit të këtyre elementëve kufizon mundësinë për verifikimin e zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Integritetit dhe për vlerësimin e nivelit të meritokracisë në menaxhimin e burimeve njerëzore në institucion.

Në përputhje me Strategjinë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit dhe kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë, Bashkia Pogradec ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2022–2025, i cili përbën instrumentin kryesor strategjik për menaxhimin e riskut të integritetit në institucion. Ky dokument synon të identifikojë dhe trajtojë risqet që lidhen me proceset administrative dhe operacionale të bashkisë, si dhe të përmirësojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe standardet e etikës institucionale. Ky raport synon të vlerësojë nivelin e integritetit institucional në Bashkinë Pogradec përmes analizës së kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe të zbatimit të tij në praktikë, duke marrë në konsideratë informacionin e publikuar në faqen zyrtare të bashkisë dhe dokumentacionin përkatës strategjik dhe rregullator. Vlerësimi është realizuar në funksion të evidentimit të progresit të arritur në zbatimin e masave të Planit të Integritetit dhe identifikimit të boshllëqeve që mund të ndikojnë në funksionimin efektiv të mekanizmave të integritetit institucional. Në këtë kuadër, analiza është fokusuar në pesë fusha kryesore të integritetit institucional, të cilat lidhen me llogaridhënien, transparencën

proaktive, qasjen strategjike ndaj integritetit, standardet etike dhe të sjelljes së mirë, si dhe meritokracinë në menaxhimin e burimeve njerëzore në institucion.

Procesi i vlerësimit është bazuar në metodologjinë e Indeksit të Integritetit për institucionet publike dhe është realizuar përmes analizës së dokumentacionit institucional dhe informacionit të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec.

Monitorimi është kryer nëpërmjet:

- analizës së Planit të Integritetit 2022–2025;
- shqyrtimit të raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit për vitet 2023 dhe 2024;
- verifikimit të dokumentacionit të publikuar në faqen zyrtare të bashkisë në lidhje me Programin e Transparencës, dokumentet rregullatore dhe mekanizmat e llogaridhënies publike.

Vlerësimi është realizuar në dy dimensione kryesore:

- kontrolli ligjor dhe institucional;
- kontrolli i zbatimit në praktikë.

2.1. Llogaridhënia

2.1.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Bashkia Pogradec ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore dhe dokumentet strategjike që lidhen me forcimin e integritetit institucional. Në këtë kuadër, Plani i Integritetit për periudhën 2022–2025 përbën dokumentin bazë strategjik për menaxhimin e riskut të integritetit në institucion. Gjithashtu, në faqen zyrtare të bashkisë është publikuar Programi i Transparencës, i cili përmban informacion mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit, si dhe të dhëna mbi strukturën organizative dhe dokumentet rregullatore.

2.1.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Nga monitorimi i faqes zyrtare rezulton se Bashkia Pogradec ka publikuar një sërë dokumentesh që lidhen me transparencën financiare, përfshirë buxhetin vjetor, paketën fiskale dhe raportet mbi monitorimin e zbatimit të buxhetit. Megjithatë, evidentohet se publikimi i dokumenteve që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e Planit të Integritetit nuk është i plotë, duke kufizuar mundësinë e verifikimit të progresit nga publiku dhe aktorët e interesuar.

2.2. Transparenca proaktive

2.2.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Bashkia Pogradec ka miratuar Programin e Transparencës në përputhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Programi përfshin publikimin e informacionit mbi legjislacionin vendor, politikat institucionale, vendimet e organeve të bashkisë dhe proceset e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje. Në faqen zyrtare të bashkisë është gjithashtu i aksesueshëm regjistri elektronik i kërkesave për informacion dhe informacion mbi konsultimet publike .

2.2.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Nga monitorimi rezulton se një pjesë e konsiderueshme e informacionit institucional është e publikuar në faqen zyrtare të bashkisë. Megjithatë, publikimi i dokumenteve që lidhen me zbatimin e masave të Planit të Integritetit mbetet i kufizuar.

2.3. Qasja strategjike ndaj integritetit

2.3.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Bashkia Pogradec ka hartuar Planin e Integritetit për periudhën 2022–2025, në të cilin janë përcaktuar objektivat dhe masat për trajtimin e risqeve të integritetit në institucion.

2.3.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Referuar raporteve të monitorimit për vitet 2023 dhe 2024, rezulton se një pjesë e konsiderueshme e masave të planifikuara janë realizuar ose janë në proces zbatimi. Megjithatë, jo të gjitha masat e raportuara si të realizuara janë reflektuar në mënyrë të plotë në faqen zyrtare të bashkisë.

2.4. Standardet etike dhe të sjelljes së mirë

2.4.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Në faqen zyrtare të bashkisë janë publikuar dokumente që lidhen me standardet etike të administratës, përfshirë Kodin e Sjelljes dhe rregulloret për konfliktin e interesit. Gjithashtu, është publikuar edhe rregullorja për sinjalizuesit dhe informacion mbi mekanizmat e sinjalizimit të shkeljeve.

2.4.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Publikimi i këtyre dokumenteve përbën një hap pozitiv në drejtim të forcimit të transparencës institucionale, megjithatë evidentohet mungesa e publikimit të raporteve mbi funksionimin e mekanizmave të sinjalizimit.

2.5. Meritokracia e burimeve njerëzore

2.5.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Menaxhimi i burimeve njerëzore realizohet në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil dhe procedurat e brendshme të institucionit.

2.5.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Nga monitorimi i faqes zyrtare rezulton se janë publikuar njoftime për vende të lira pune në administratë, duke reflektuar transparencë në proceset e rekrutimit. Megjithatë, informacioni mbi zhvillimin profesional të stafit dhe trajnimet mbetet i kufizuar.



Plani i Integritetit konsiderohet si një instrument strategjik për identifikimin dhe trajtimin e risqeve të integritetit në institucionet publike, si dhe për përmirësimin e standardeve të etikës institucionale dhe menaxhimit të burimeve njerëzore. Nga monitorimi i faqes zyrtare të Bashkisë Shkodër nuk evidentohet publikimi i Planit të Integritetit si dokument strategjik institucional. Mungesa e këtij dokumenti përbën një mangësi në qasjen strategjike të institucionit ndaj menaxhimit të riskut të integritetit dhe kufizon mundësinë për një vlerësim të plotë të masave të ndërmarra në këtë drejtim. Megjithatë, në faqen zyrtare të bashkisë janë publikuar një sërë dokumentesh që lidhen me transparencën institucionale dhe standardet etike të administratës publike, të cilat kontribuojnë në forcimin e integritetit institucional. Ky raport synon të vlerësojë nivelin e integritetit institucional në Bashkinë Shkodër përmes analizës së kuadrit ligjor dhe institucional dhe nivelit të zbatimit në praktikë, duke marrë në konsideratë informacionin e publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.

3.1. Llogaridhënia

3.1.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Llogaridhënia institucionale përbën një nga shtyllat kryesore të mirëqeverisjes në nivel vendor dhe lidhet drejtpërdrejt me transparencën dhe përgjegjshmërinë e administratës publike ndaj qytetarëve. Në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër është publikuar Programi i Transparencës, i cili përmban informacion mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit, strukturën organizative dhe kompetencat e drejtorive përkatëse. Gjithashtu, në faqen zyrtare janë të publikuara dokumente që lidhen me menaxhimin financiar të bashkisë, përfshirë buxhetin vjetor dhe raportet mbi monitorimin e zbatimit të tij.

3.1.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Nga monitorimi i faqes zyrtare rezulton se Bashkia Shkodër ka ndërmarrë masa për publikimin e informacionit financiar dhe institucional, duke reflektuar një nivel të caktuar transparence në menaxhimin e burimeve publike. Megjithatë, mungesa e publikimit të një Plani të Integritetit kufizon mundësinë për monitorimin e progresit institucional në trajtimin e risqeve të integritetit dhe në forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm.

3.2. Transparenca proaktive

3.2.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Programi i Transparencës i Bashkisë Shkodër është publikuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit për të drejtën e informimit dhe përfshin publikimin e informacionit mbi aktivitetin e institucionit, vendimet e organeve të bashkisë dhe dokumentet strategjike.

3.2.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Nga monitorimi i faqes zyrtare evidentohet publikimi i një pjese të konsiderueshme të informacionit institucional dhe financiar. Megjithatë, nuk evidentohet publikimi i dokumenteve strategjike që lidhen me menaxhimin e integritetit institucional, si dhe mungon publikimi i informacionit mbi trajtimin e kërkesave për informacion dhe konsultimet publike në mënyrë të strukturuar.

3.3. Qasja strategjike ndaj integritetit

3.3.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Nga monitorimi i faqes zyrtare të Bashkisë Shkodër nuk evidentohet ekzistenca e një Plani të Integritetit të publikuar online, çka përbën një mangësi në qasjen strategjike të institucionit ndaj menaxhimit të riskut të integritetit.

3.3.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Mungesa e këtij dokumenti strategjik kufizon zhvillimin e një qasjeje të strukturuar ndaj integritetit institucional dhe trajtimit të risqeve të identifikuar në proceset e punës së bashkisë.

3.4. Standardet etike dhe të sjelljes së mirë

3.4.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër janë publikuar dokumente që lidhen me standardet etike të administratës publike dhe mekanizmat për trajtimin e sinjalizimeve.

3.4.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Nga monitorimi rezulton se mekanizmat e sinjalizimit janë të aksesueshëm për qytetarët, megjithatë nuk evidentohet publikimi i statistikave mbi trajtimin e rasteve të sinjalizuara.

3.5. Meritokracia e burimeve njerëzore

3.5.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Menaxhimi i burimeve njerëzore realizohet në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil dhe procedurat e brendshme të institucionit.

3.5.2 Kontrolli i zbatimit në praktikë

Nga monitorimi i faqes zyrtare rezulton se janë publikuar njoftime për vende të lira pune në administratë. Megjithatë, nuk evidentohet publikimi i informacionit mbi trajnimet e stafit në fushën e integritetit dhe etikës institucionale.

KRAHASIM

MIDIS TRE BASHKIVE

Ky seksion paraqet një vlerësim krahasues të nivelit të integritetit institucional në tre njësi të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, përkatësisht Bashkinë Pogradec, Bashkinë Elbasan dhe Bashkinë Shkodër. Vlerësimi është realizuar në përputhje me metodologjinë e Indeksit të Integritetit, duke analizuar përputhshmërinë ndërmjet kuadrit ligjor dhe institucional të brendshëm dhe zbatimit të tij në praktikë.

Analiza është bazuar në shqyrtimin e Planeve të Integritetit të miratuara nga bashkitë përkatëse, raporteve të monitorimit të zbatimit të tyre, si dhe informacionit të publikuar në faqet zyrtare të institucioneve në kuadër të transparencës proaktive dhe llogaridhënies publike.

Rezultatet e vlerësimit tregojnë se Bashkia Pogradec dhe Bashkia Elbasan kanë ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të hartimit dhe zbatimit të Planeve të Integritetit si instrumente strategjike për menaxhimin e riskut të integritetit, ndërsa në Bashkinë Shkodër nuk evidentohet publikimi i një dokumenti të tillë në faqen zyrtare të institucionit.

Në të tre bashkitë evidentohet ekzistenca e mekanizmave bazë të transparencës, si Programi i Transparencës dhe publikimi i informacionit financiar, si dhe funksionimi i mekanizmave të sinjalizimit. Megjithatë, monitorimi evidenton mangësi të përbashkëta në publikimin e statistikave mbi trajtimin e sinjalizimeve, zhvillimin e kapaciteteve të stafit në fushën e integritetit dhe publikimin e indikatorëve të performancës institucionale.

Gjetjet e raportit sugjerojnë se, ndonëse janë ndërmarrë hapa pozitivë në drejtim të forcimit të integritetit institucional, mbetet e nevojshme përmirësimi i transparencës proaktive dhe konsolidimi i mekanizmave strategjike për menaxhimin e riskut të integritetit, veçanërisht në Bashkinë Shkodër.

Të përbashkëtat dhe veçantitë sipas Indeksit të Integritetit

Fusha e Integritetit	Bashkia Pogradec	Bashkia Elbasan	Bashkia Shkodër
Plani i Integritetit i publikuar online	Po	Po	Jo
Plan Integriteti i përditësuar (2025–2028)	Po	Po	Nuk evidentohet
Raporte monitorimi të Planit të Integritetit	Po (2023–2024)	Nuk evidentohet publikimi online	Jo
Programi i Transparencës	Po	Po	Po
Publikimi i buxhetit dhe monitorimit	Po	Po	Po
Konsultime publike të dokumentuara	Po	Po	Nuk janë të strukturuar
Kodi i Etikës i publikuar	Jo i plotë	Jo i plotë	Po
Konflikti i interesit (procedura)	Evidentohet në Planin e Integritetit	Evidentohet në Planin e Integritetit	Nuk evidentohet
Mekanizmi i Sinjalizimit	Po	Po	Po
Statistika mbi sinjalizimet	Jo	Jo	Jo
Rekrutimi (njoftime online)	Po	Po	Po
Trajnime mbi integritetin	Evidentohen në Planin e Integritetit	Evidentohen në Planin e Integritetit	Nuk evidentohet
Publikimi i kontratave të prokurimit	I pjesshëm	I pjesshëm	I pjesshëm
Dashboard / indikatorë KPI	Jo	Jo	Jo

Nga analiza e informacionit të publikuar në faqet zyrtare të Bashkisë Pogradec, Bashkisë Elbasan dhe Bashkisë Shkodër rezulton se të tre institucionet kanë ndërmarrë hapa në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni për transparencën dhe llogaridhënien publike. Në këtë kuadër, evidentohet se në të tre bashkitë është publikuar Programi i Transparencës, si dhe informacion mbi buxhetin vjetor dhe monitorimin e zbatimit të tij. Gjithashtu, në faqet zyrtare të institucioneve evidentohet ekzistenca e mekanizmave të sinjalizimit dhe publikimi i njoftimeve për vende të lira pune në administratë.

Megjithatë, monitorimi i faqes zyrtare të bashkive tregon se asnjë prej tyre nuk publikon statistika mbi funksionimin e mekanizmave të sinjalizimit apo trajtimin e rasteve të raportuara. Po ashtu, nuk evidentohet publikimi i indikatorëve të performancës institucionale që lidhen me integritetin, ndërsa kontratat e prokurimit publik publikohen në mënyrë të pjesshme, duke kufizuar transparencën proaktive në këtë drejtim.

Nga ana tjetër, analiza evidencon disa dallime në qasjen strategjike të bashkive ndaj integritetit institucional. Bashkia Pogradec ka të publikuar online Planin e Integritetit dhe raporte monitorimi mbi zbatimin e tij, si dhe evidentohet zhvillimi i konsultimeve publike të dokumentuara, çka tregon një qasje më të strukturuar strategjike ndaj menaxhimit të riskut të integritetit.

Ndërkohë, Bashkia Elbasan ka hartuar dhe publikuar një Plan të Integritetit të përditësuar për periudhën 2025–2028, i cili përfshin indikatorë të performancës dhe një sistem për menaxhimin e riskut institucional. Plani parashikon gjithashtu zhvillimin e një platforme për publikimin e të dhënave në kohë reale, duke reflektuar një qasje më të avancuar konceptuale ndaj integritetit institucional.

Në rastin e Bashkisë Shkodër, nga monitorimi i faqes zyrtare nuk evidentohet publikimi i një Plani të Integritetit apo i raporteve të monitorimit të zbatimit të tij. Gjithashtu, nuk evidentohet publikimi i informacionit mbi zhvillimin e trajnimeve për stafin në fushën e integritetit, çka sugjeron një qasje më të dobët strategjike ndaj menaxhimit të riskut të integritetit në institucion.

REKOMANDIME

V.

Bashkia Elbasan

- Bazuar në analizën e Planit Vendor të Integritetit 2025–2028 dhe monitorimin e informacionit të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan, evidentohet nevoja për ndërmarrjen e një sërë masash që synojnë përmirësimin e transparencës proaktive dhe forcimin e mekanizmave institucionalë të integritetit.
- Në këtë kuadër, rekomandohet publikimi në faqen zyrtare i regjistrit të riskut të integritetit dhe përditësimi periodik i tij, me qëllim rritjen e transparencës mbi menaxhimin e risqeve institucionale. Gjithashtu, rekomandohet publikimi i raporteve periodike mbi zbatimin e masave të Planit të Integritetit, në mënyrë që të mundësohet monitorimi i progresit institucional nga publiku dhe aktorët e interesuar.
- Në funksion të forcimit të transparencës proaktive, rekomandohet publikimi në format të hapur i kontratave të prokurimit publik dhe indikatorëve të performancës institucionale që lidhen me integritetin dhe ofrimin e

shërbimeve publike. Po ashtu, sugjerohet rritja e aksesit të qytetarëve në informacion mbi konsultimet publike dhe proceset vendimmarrëse në nivel vendor.

- Në drejtim të përmirësimit të standardeve etike në administratë, rekomandohet publikimi i Kodit të Etikës të përditësuar për punonjësit e bashkisë, si dhe hartimi dhe publikimi i procedurave të brendshme për deklarimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit. Gjithashtu, sugjerohet publikimi i informacionit mbi zhvillimin e trajnimeve për stafin në fushën e etikës dhe integritetit institucional.
- Në kuadër të promovimit të meritokracisë në menaxhimin e burimeve njerëzore, rekomandohet publikimi i informacionit mbi trajnimet e zhvilluara për punonjësit dhe përfshirja e elementëve të integritetit në procesin e vlerësimit të performancës së stafit.
- Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të kontribuonte në përmirësimin e praktikave institucionale dhe në forcimin e integritetit dhe llogaridhënies publike në Bashkinë Elbasan.

Bashkia Pogradec

- Bazuar në analizën e Planit të Integritetit të Bashkisë Pogradec për periudhën 2022–2025 dhe monitorimin e informacionit të publikuar në faqen zyrtare të institucionit, evidentohet nevoja për ndërmarrjen e një sërë masash që synojnë përmirësimin e transparencës proaktive dhe forcimin e mekanizmave institucionalë të integritetit.

- Në këtë kuadër, rekomandohet publikimi periodik i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit në faqen zyrtare të bashkisë, në mënyrë që të mundësohet akses i plotë i publikut në informacion mbi progresin e realizimit të masave të planifikuara. Gjithashtu, sugjerohet publikimi i dokumenteve që lidhen me kuadrin rregullator të brendshëm institucional, përfshirë procedurat për deklarimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit dhe standardet etike të administratës publike.
- Në funksion të rritjes së transparencës proaktive, rekomandohet publikimi në format të hapur i kontratave të prokurimit publik dhe informacionit mbi zhvillimin e konsultimeve publike. Po ashtu, sugjerohet publikimi i statistikave mbi funksionimin e mekanizmave të sinjalizimit dhe trajtimin e rasteve të raportuara nga qytetarët.
- Në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të burimeve njerëzore, rekomandohet publikimi i informacionit mbi zhvillimin e trajnimeve për stafin në fushën e etikës dhe integritetit institucional, si dhe rritja e transparencës në proceset e zhvillimit profesional të punonjësve.
- Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të kontribuonte në përmirësimin e praktikave institucionale dhe në forcimin e integritetit dhe llogaridhënies publike në Bashkinë Poqgradec.

Bashkia Shkodër

- Bazuar në analizën e informacionit të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe në mungesën e një Plani të Integritetit të publikuar si dokument strategjik institucional, evidentohet nevoja për ndërmarrjen e masave konkrete që synojnë forcimin e integritetit institucional dhe përmirësimin e transparencës proaktive.
- Në këtë kuadër, rekomandohet hartimi dhe publikimi i Planit të Integritetit si një instrument strategjik për menaxhimin e riskut të integritetit në institucion, në mënyrë që të mundësohet identifikimi dhe trajtimi i risqeve që lidhen me proceset administrative dhe operacionale të bashkisë.
- Gjithashtu, sugjerohet publikimi i dokumenteve që lidhen me standardet etike të administratës publike dhe procedurat për deklarimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit, me qëllim rritjen e transparencës institucionale dhe përmirësimin e praktikave të brendshme në drejtim të integritetit.
- Në funksion të rritjes së transparencës proaktive, rekomandohet publikimi i statistikave mbi funksionimin e mekanizmave të sinjalizimit dhe trajtimin e rasteve të raportuara nga qytetarët, si dhe përmirësimi i aksesit të publikut në informacion mbi konsultimet publike dhe proceset vendimmarrëse.

- Në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të burimeve njerëzore, sugjerohet publikimi i informacionit mbi zhvillimin e trajnimeve për stafin në fushën e etikës dhe integritetit institucional, si dhe rritja e transparencës në proceset e rekrutimit dhe zhvillimit profesional të punonjësve.
- Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të kontribuonte në forcimin e mekanizmave të integritetit institucional dhe në rritjen e llogaridhënies publike në Bashkinë Shkodër.

